



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 28.04.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, znj. Mimoza Kusari-Lila, duke u bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.14/2011 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik, e miratoi këtë:

V E N D I M

I. Formohet Komisioni për intervistimin e kandidatëve në bazë të konkursit të shpallur nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit të dt.16.04.2014, për angazhimin e 20 (njëzet) punëtorëve për identifikimin, verifikimin, evidentimin dhe regjistrimin e objekteve të ndërtuara me dhe pa leje ndërtimi në tërë territorin administrativ të Komunës së Gjakovës (Zona urbane dhe rurale), në këtë përbërje:

1. Elida Bejtullahu, kryesuese e Komisionit
2. Hana Hoxha, anëtare
3. Dardan Krypa, anëtar
4. Lumnije Shllaku, anëtare
5. Armend Behluli, anëtar

II. Komisioni do të filloi punën në shqyrtimin e dokumentacionit të kandidatëve të paraqitur, menjëherë pas mbylljes së konkursit.

A r s y e t i m

Komisioni do të bëjë shqyrtimin e dokumentacionit, përpilimin e listës së ngushtë dhe do të intervistoi kandidatët me gojë. Në bazë të rezultateve të arritura në intervistim dhe kushteve të parapara me konkurs Komisioni do të përcaktohet për kandidatet që më së miri i plotësojnë kushtet sipas konkursit.

Më qëllim të respektimit të procedurave ligjore lidhur me selektimin dhe rekrutimin e kandidatëve që kanë aplikuar për këto vende të punës, u caktua komisioni si në piken I të këtij vendimi.

CC: - Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Anëtarëve të Komisionit
- Arkivit

Kryetarja e Komunës

Znj. Mimoza Kusari-Lila

